



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i*  
*Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

**RAPORTI GJASHTËMUJOR JANAR-QERSHOR 2022 I ZBATIMIT TË  
STRATEGJISË KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR  
PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E EKONOMISË JO-FORMALE,  
PASTRIMIN E PARAVE, FINANCIMIN E TERRORIZMIT DHE  
KRIMEVE FINANCIARE  
2019-2023**

**MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE**

Nëntor 2022, Prishtinë, Kosovë

## Lista e shkurtesave

ARBK - Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

DK - Dogana e Kosovës

DPFTF – Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve Financiare

DPMBNF – Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

FT - Financimi i Terrorizmit

MAP – Ministria e Administratës Publike

MD – Ministria e Drejtësisë

MF – ish Ministria e Financave

MFPT – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MPMS – ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

NJIF - Njësia e Inteligjencës Financiare

PK - Policia e Kosovës

PP - Pastrimi i Parave

SKZH - Strategjia Kombëtare e Zhvillimit

SLEJ – Strategjia për Luftimin e Ekonomisë Joformale

TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	2
Informata të përgjithshme.....	4
Progresi i përgjithshëm.....	4
Problemet dhe rreziqet.....	5
Hapat e ardhshëm .....	6
Informacione të detajuara për zbatimin e aktiviteteve.....	6
Objektivi Strategjik I.....	21
Objektivi Strategjik II.....	29
Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues të Strategjisë Kombëtare.....	35

## Lista e Grafikëve

<b>Grafiku 1:</b> Progresi në zbatimin e aktiviteteve të SLEJ për periudhën janar - qershor 2022.....	6
<b>Grafiku 2:</b> Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik I.....	21
<b>Grafiku 3:</b> Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik II.....	30
<b>Grafiku 4:</b> Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues të Strategjisë Kombëtare.....	35

## Informata të përgjithshme

### Progresi i përgjithshëm

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 (tani e tutje SLEJ 2019-2023) ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm në Kosovë për të luftuar ekonominë joformale, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare për tu integruar në luftën rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar paqe sociale, mirëqenie, dinjitet, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në përputhje me politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës (tani e tutje QRK).

Strategjia Kombëtare përmban dy objektiva strategjike, shtatë objektiva specifike si dhe 71 aktivitete.

Objektivat strategjike që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj Strategjie janë:

- Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.

Këto dy objektiva janë shprehje e përmirësimit sasior dhe cilësor të cilat Qeveria i mendon si themeltare për t'u përballur me sfidat dhe problemet e ekonomisë joformale. Po ashtu ato janë edhe një jetësim i angazhimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në dialogun me Bashkimin Evropian (BE) gjatë vitit 2018, përputhshmëri me dokumentin themeltar Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (SKZH) dhe Programin e Reformave Ekonomike 2019-2021 si dhe dokumente të tjera strategjike të Kosovës.

Ky dokument paraqet Raportin e parë gjashtëmuor të zbatimit të Strategjisë Kombëtare që nga miratimi i saj në fund të tremujorit të dytë të vitit 2019 dhe përfshin periudhën raportuese janar - qershor 2022. Raporti është bazuar në Planin e Veprimit dhe raporton për përmbushjen e aktiviteteve në kuadër të objektivave strategjike dhe specifike. Raporti është përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse në harmoni me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr.07/2018 dhe ndjek procedurat dhe praktikat e rregullta të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Gjatë periudhës raportuese, lidhur me Objektivin Strategjik I mund të themi se është arritur të përmbushet pjesërisht ajo çfarë është synuar. Ky objektivi përmban në vete katër (4) objektiva specifike dhe gjithsej pesëdhjetë e tre (53) aktivitete, prej të cilave njëzetë (20) apo 38% prej tyre janë zbatuar, njëzetë (20) apo 38% janë në proces të zbatimit, kurse trembëdhjetë (13) apo 25% nuk janë zbatuar.

Në kuadër të Objektivit Strategjik I, performancë më e mirë u arrit në fushën e vlerësimit dhe përdorimit të të dhënave lidhur me ekonominë joformale nga institucionet përkatëse, rritjen e numrit të bizneseve të pajisura me arka fiskale, rritjen e veprimeve të koordinuara për kontroll dhe inspektim në bizneset me rrezik të lartë, fillimin e hetimit financiar për rastet kur dyshohet në korrupsion dhe vepra tjera penale dhe shtimin e aktiviteteve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë.

Ndërsa, aktivitetet në të cilat ka pasur ngecje gjatë periudhës raportuese janë: realizimi i anketës për çmimet e tokës bujqësore, publikimi i vazhdueshëm i të dhënave të fushës së financave publike sipas formatit të të dhënave të hapura në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura, pasqyrimi në raportin vjetor të zbatimit të Strategjisë Kombëtare i të ardhurave nga ekonomia joformale, gri dhe e zezë, realizimi i

pagesave të të punësuarve nga ana e punëdhënësit nëpërmes sistemit bankar, plotësim ndryshimi i Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, zhvillimi dhe prezantimi i moduleve të reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat në sektorë dhe pajisja e inspektorëve me mjete pune dhe vetura.

Ndërsa sa i përket Objektivit Strategjik II mund të konsiderojmë se është përmbushur në pjesën më të madhe të tij. Ky objektivi përmban në vete tre (3) objektiva specifikë dhe gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktivitete, prej të cilave njëmbëdhjetë (11) apo 61% janë zbatuar, dy (2) apo 11% janë në proces, ndërsa pesë (5) apo 28% nuk janë zbatuar.

Progres i konsiderueshëm në kuadër të këtij objektivi strategjik u shënuar në krijimin e grupeve të përbashkëta në mes të DK dhe ATK me qëllim kontrollin e mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangies së taksave. Poashtu, performancë e mirë u shënuar edhe në hetimin dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta me qëllim luftimin e kontrabandës së mallrave, rritjen e numrit të patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës, rritjen e aktiviteteve të ndërmarra në parandalimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë Intelktuale – IPR, realizimin e trajnimeve në ATK lidhur me fushën e menaxhimit të rrezikut dhe në DK në fushën e zbatimit të ligjit, trajnime të Prokurorëve për veprën penale të krimit ekonomik dhe pastrimin e parave, trajnime për institucionet që monitorojnë aktivitetet në sektorin e ndërtimitarisë mbi PP/FT lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet tjera financiare dhe ngritjen e aftësive profesionale të Prokurorëve, Gjykatësve, Hetuesve dhe zyrtarëve të Inteligjencës Financiare në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ndërsa, aktivitetet në të cilat ka pasur ngecje gjatë periudhës raportuese janë: kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave me objektivi ekonominë joformale, vlerësimi i hendekut tatimor sipas standardeve ndërkombëtare, ulja e pragut lidhur me transaksionet në mes bizneseve të cilat bëhen në kesh, dizajnimi i softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me numrin e kuponëve fiskal të lëshuar, kohën dhe artikujt në kohë reale (online) dhe përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal.

## Problemet dhe rreziqet

Situata pandemike në vend ka ndikuar që fillimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të përballet me sfida të paparashikueshme. Me ndërmarrjen e masave për ta luftuar pandeminë është ndikuar edhe puna e institucioneve zbatuese dhe raportuese të Strategjisë Kombëtare. Si pasojë, një pjesë e aktiviteteve të planifikuara gjatë periudhës së pandemisë nuk janë realizuar sipas planit.

Ndërsa, ngecja në progres gjatë periudhës raportuese vjen kryesisht si rezultat i vazhdimit të pengesave nga pandemia në realizimin e aktiviteteve, mungesës së stafit dhe qarkullimit të madh të stafit në departamente kyçe.

## Hapat e ardhshëm

Pas tejkalimit të situatës me pandeminë sugjerohet që institucionet përgjegjëse ta rrisin bashkëpunimin ndërinstytucional, duke prioritetizuar aktivitetet e Strategjisë Kombëtare dhe realizimin e tyre sipas afateve të përcaktuara.


Lidhur me Objektivin Strategjik I, për t'i tejkaluar ngecjet e raportuara sugjerohet riplanifikimi i afateve të zbatimit të aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse, përgatitja e infrastrukturës ligjore për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare, dokumentimi i proceseve të punës në departamente me qarkullim të madh të punëtorëve dhe rritja e kapaciteteve të stafit përkatës për zbatimin e aktiviteteve të caktuara në Strategjinë Kombëtare.

Ngjashëm edhe me Objektivin Strategjik II sugjerohet riplanifikimi i afateve të zbatimit të aktiviteteve të ndikuara nga pandemia dhe dokumentimi i proceseve të punës tek departamentet me qarkullim të lartë të stafit.

## Informacione të detajuara për zbatimin e aktiviteteve

Sa i përket progresit të shënuar në zbatimin e Strategjisë Kombëtare gjatë periudhës janar-qershor 2022, vlen të theksohet se pas përmirësimit të situatës me pandeminë, institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të SLEJ 2019-2023 kanë punuar më intenzivisht në zbatim të aktiviteteve për luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare. Si rezultat i kësaj, siç shihet edhe në Grafikonin 1 në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, nga gjithsej 71 aktivitete të planifikuara, tridhjetë e një (31) apo 44% prej tyre janë zbatuar, njëzetë e dy (22) apo 31% janë në proces të zbatimit, ndërsa tetëmbëdhjetë (18) apo 25% prej tyre nuk janë zbatuar ende.

**Grafiku 1:** Progresi në zbatimin e aktiviteteve të SLEJ për periudhën janar - qershor 2022



Burimi: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimet Financiare 2019-2023

Tabela në vijim pasqyron statusin e zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe vazhdon me një përshkrim të shkurtër të progresit për secilin aktivitet.

**Tabela 1: Zbatimi i aktiviteteve të SLEJ 2019-2023 gjatë periudhës janar – qershor 2022**

Aktiviteti	Afati i fundit	Burimi i Financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Outputi)	Referenca në dokumente	Progresi në zbatim
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit</b>						
<b>Objektivi specifik 1: Përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.</b>						
1.1.1 Avancimi në përdorimin e të dhënave të anketave statistikore nga ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës) në modelet e vlerësimit të ekonomisë joformale në Kosovë, në parashikimet makro-fiskale të Ministrisë së Financave (MF) dhe masave politike të adresuara në strategji sektoriale	K1 2020 dhe vazhdueshëm	Buxh.	MF/DPMB NF	Referenca dhe të dhënat e anketave të ASK mbi ekonominë e pa vrojtuar janë pjesë e studimeve/publikimeve të parashikimeve makro fiskale të MF	Publikimet zyrtare të MF Publikimet e ASK	Zbatuar
1.1.2 Sigurimi i pajtueshmërisë së të dhënave të ASK lidhur me ekonominë joformale në përputhje me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare	K4 2020 dhe vazhdueshëm	Buxh.	ASK	Raportime të përditësuara të treguesve /të dhënave statistikore	Publikimet zyrtare të ASK	Zbatuar
1.1.3 Realizimi i anketës për çmimet e tokës bujqësore nga ASK	K4 2021	Buxh.	ASK	- Plani Vjetor i Punës i ASK i cili përmban këtë aktivitet i miratuar -Buxheti i alokuar - Anketa e Zhvilluar dhe rezultatet e publikuara në formën e paraparë nga ASK	Publikime të ASK dhe MF	Pazbatuar

1.1.4 Përgatitja e një udhëzuesi mbi Metodologjinë e Vlerësimit të impaktit të ndryshimeve tatimore (Tax Expenditure), i cili të zbatohet ose praktikohet përpara miratimit të çdo mase fiskale të propozuar.	K2 2019		<b>MF/DPFTF</b>	Udhëzues i brendshëm dhe Instruksioni përkatës i hartuar dhe i miratuar	Raportime të DPFTF	Zbatuar
1.1.5 Specifikimi në thesar i komponentëve të pagesave nga tatimpaguesit: i) Gjobë, ii) Ndëshkim, iii) Interes, iv) Shmangie tatimore, v) Lloj Tatimi	K4 2019 dhe vazhdueshëm	Buxh.	<b>MF/Thesari i Kosovës; ATK</b>	- Të dhënat MF për të hyrat e Kosovës të përmirësuara dhe të strukturuar. - Raporte mbi efektin e masave parandaluese dhe ndëshkuese të informalitetit me referencë të dhënat e Thesarit	- Publikime të MF - Publikime të ATK	Zbatuar
1.1.6 Rritja e mbikëqyrjes nga BQK (Banka Qendrore e Kosovës) për përshkrimin e transaksioneve financiare nga bankat në mënyrë që të rritet dobia e informacionit për analiza cilësore në organet përkatëse	K4 2019 – K4 2022		<b>BQK</b>	Udhëzime apo përditësime të udhëzimeve zyrtare përkatëse nga BQK	Publikime dhe raportime të BQK	Zbatuar
1.1.7 Krijimi i një sistemi ndër bankar të pagesave me qëllim të stimulimit të pagesave me kartelë dhe formave të tjera të pagesave duke zvogëluar në masë përdorimin e kesh-it si mjet pagese	K2 2020 – K4 2022		<b>BQK; Qeveria e Republikës së Kosovës</b>	Implementimi i një sistemi ndër bankar të pagesave që lehtëson kryerjen e transaksioneve në formë elektronike	Publikimi në ueb faqen e BQK -së	Në proces
1.1.8 Dhënia e Kredive bankare bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në ATK dhe të certifikuar nga ekspertët e lëmisë për të gjitha bizneset që janë të obliguara të dorëzojnë pasqyrat në këtë institucion	K4 2019	Buxh.	<b>BQK</b>	Rregullorja, udhëzimi dhe instruksioni përkatës për Korporatat Financiare i përmirësuar	Publikimet e BQK	Në proces
1.1.9 Publikimi i vazhdueshëm i të dhënave të fushës së financave publike sipas formatit të të	K2 2020	Don.	<b>MAP</b>	- Pesë (5) data sete për Buxhetin e Republikës së	Projekt Ligji për Qasje në dokumente publike;	Pazbatuar



dhëname të hapura në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura				Kosove, të publikuara në Portal; - Shtatë (7) data sete për Borxhin Publik, të publikuara në Portal; - Pesë (5) data sete për Shpenzimet Publike, të publikuara në Portal;	Karta për Hapjen e të Dhëna në Republikën e Kosovës; Vendimi nr. 07/87, datë: 13.05.2016, i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimi nr. 05/84, datë: 15.01.2019, i Qeverisë së Republikës së Kosovës	
1.1.10 Zgjerimi i gamës së Vlerësimeve të Rrezikut nga NJIF (Njësia e Inteligjencës Financiare) duke shtuar vlerësimin e Sektorit Financiar	K4 2019	Don.	<b>NJIF</b>	Dok.Vleres.i Risk.ne sekt. Specif. - financiar PLANI i VEPRIMIT për trajtimin e masave nga vle.Ris.ne sekt.fin.	FATF Rek.nr. 1 Strategjia Kombëtare. Paran.Luft. ekonomis joformale PP/FT/KRI ME FINA. - Plani i Veprimit te Strategjis.	Në proces
<b>Objektivi Specifik I.2 Rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit</b>						
1.2.1 Rritja e aktiviteteve të komunikimit me publikun (numrin, pjesëmarrësit dhe buxheti) për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të qytetarëve nga organet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie	Vazhdueshëm		<b>MF/</b> <b>ATK;</b> <b>DK;</b> <b>MPMS;</b> <b>PK</b>	Raportime gjashtëmujore	Raportet e Zbatimit të Strategjisë - website i MF	Në proces

1.2.2 Rritja e numrit të konferencave, punëtorive, takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale për të diskutuar ndikimin e masave të luftës kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare (anëtarësisë së këtyre shoqatave, numri i pjesëmarrësve dhe dokumentet e konferencave)	Vazhdueshëm	Buxh.	<b>MF/</b> ATK; NJIF; MPMS; DK; PK	Raportime gjashtë mujore	- Raportet e Zbatimit të Strategjisë - website i MF	Në proces
1.2.3 Pasqyrimi në raportin vjetor të zbatimit të strategjisë lidhur me të ardhurat nga ekonomia joformale gri dhe e zezë në faqen e internetit të MF	K4 2019 dhe vazhdueshëm		<b>MF/</b> ATK; NJIF; MPM; D; PK	Raportime Vjetore pas publikimit të llogarive kombëtare	Raportet e Zbatimit të Strategjisë. website i MF	Pazbatuar
1.2.4 Përgatitja dhe Publikimi i Fletëpalosjes me informacion për publikun rreth efektit të pritur në parandalimin e ekonomisë joformale nga zbatimi i masave të parapara sipas nenit 64 të MSA mbi sistemet e Pagesave	K4 2019 dhe vazhdueshëm	Buxh.	<b>BQK</b>	2 seri me 1000 copë Fletëpalosjeve/vit	- Fatura e Pagesave - Foto - Pasqyrat e Inventarit të Hyrjeve dhe Daljeve nga MF apo institucione, Qendra e Botimeve Zyrtare.	Zbatuar
1.2.5 Të bëhet një studim lidhur me procesin e vlerësimit të çmimit të pronës, regjistrimit të të patundshmeve në rast blerjeje për herë të parë apo transferimi në mënyrë që vlera e asetit të regjistruar të pasqyrojë vlerën aktuale të tregut	K1 2020	Buxh. Don.	Kadastra; <b>MF/</b> <b>Departamenti i Tatimit mbi Pronën;</b> Komunat; BQK; MD	Dokumenti i Studimit apo Drafti i Aktit Ligjor/Nënligjor	Publikimet Zyrtare: Qeveria e Kosovës Kuvendi i Kosovës	Pazbatuar

1.2.6 Të funksionalizohet sistemi i unifikuar i adresave	K2 2020 Studimi Në varësi të afateve të parapara në Studim deri në fund të vitit 2022	Buxh. Don:	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Agjencioni Kadastral i Kosovës; Komunat.	Projekti i unifikimit të adresave	Publikimet Zyrtare: Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Mjedisit, Kuvendi i Kosovës	Në proces
1.2.7 Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist	K1 2021	Buxh.	<b>MF/</b> ATK	Koncept dokumenti i aprovuar	Ueb i ZKM	Pazbatuar
1.2.8 Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore familjare të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist	K1 2021		<b>MF/</b> ATK	Koncept dokumenti i aprovuar	Ueb i ZKM	Pazbatuar
1.2.9 Të gjitha pagesat e të punësuarve nga ana epunëdhënësit të bëhen nëpërmjet sistemit bankar	K4 2019	Buxh.	<b>MPMS;</b> <b>MF/ATK</b>	Ligji i Punës	Ueb i MPMS	Pazbatuar
1.2.10 Rritja e numrit të bizneseve të pajisura me arka fiskale	Në vazhdimësi	Buxh.	<b>MF/</b> ATK	Rritja e numrit të bizneseve të pajisura me PEF	ATK MF Raportet e Operatorëve të shpërndarjes së Pajisjeve Fiskale	Zbatuar
1.2.11 Të implementohet fatura elektronike në sistemin e ri të TI-së në ATK	K2 2020	Buxh.	<b>MF/</b> ATK	Implementimi i sistemit të ri të TI-së për komponentën e faturës elektronike	Ueb i ATK	Në proces
1.2.12 Plotësim/ndryshimi i Ligjit për Financimin e Partive Politike dhe nxjerrja e akteve ligjore dhe nënligjore për publikimin dhe transparencën e informacionit të financave të partive politike	K4 2019	Buxh.	<b>KQZ/</b> ZKM	Ligji i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës	Reforma e Agjendës Evropiane (ERA)	Në proces

1.2.13 Auditimi i pavarur i financave të partive politike dhe publikimi i rezultateve të tyre	K4 2020		<b>Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)</b>	- Raporte Financiare të certifikuar nga Auditorët për partitë politike - Raportet Financiare të publikuara për partitë politike	Raporti i vendit 2018 (KE)	Në proces
1.2.14 Themelimi i njësisë për Rikthimin e Aseteve të Konfiskuara	Deri në fund të vitit K2 2020 AT dhe deri në fund të vitit 2022 vënia në funksionim të plotë e Agjencisë	Don.	<b>AMSKA</b>	- Termat e Referencës të ekspertizës të hartuara dhe të Planifikuara - Buxheti për ekspertizën i alokuar dhe angazhuar për autoritetin Kontraktues - Kontrata e Lidhur		Zbatuar
1.2.15 Krijimi i fondit të konfiskimit në Kosovë	K2 2020		<b>MD</b>	Fondi i konfiskimit në Kosovë		Në proces
1.2.16 Fillimi i hetimit financiar që në fillim në raste kur dyshohet për korrupsion e për të cilat PK dhe Prokuroria e Shtetit vlerëson se ka potencial për konfiskim të pasurisë të fituar me veprë penale në përputhje me rekomandimet e FATF-së	K4 2019	Buxh.	<b>PK; Prokuroria e Shtetit</b>	Numri i Rast.Hetim.Fin.PP/FT Vlera e pronës e ngrirë, sekuestruar dhe konfiskuar	FATF Rek.nr. 30 Strat.Komb t.Paran.Luft .eko. Joform.PP/ FT/Krim.Fi nan.-Plani i Vepr te Strategj.	Zbatuar
1.2.17 Shtimi i aktiviteteve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë siç është e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës (Kapitulli XXV)	Vazhdueshëm duke filluar që prej K4 2019	Buxh.	<b>PK/Prokuroria e Shtetit; DK dhe ATK</b>	Aktivitete hetimore me objekt veprën penale kundër ekonomisë	Prokuroria e Kosovës	Zbatuar
1.2.18 Aprovimi i Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe	K4 2019	Buxh.	<b>MF/NJIF</b>	Koncept Dokumenti i aprovuar nga Qeveria	PVPQ 2019	Në proces

Luftimin e Financimit të Terrorizmit, në përputhje me praktikat e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vendit 2018 për Kosovën dhe MSA (Neni 89)						
1.2.19 Rritja e numrit të vizitave dhe kontrolleve të realizuara bazuar në vlerësimin e rrezikut në luftimin e ekonomisë joformale dhe shmangies tatimore	K3 2019 Vazhdueshëm deri në fund të 2022	Buxh.	<b>ATK</b>	- Planet e Punës të ATK - Raportet e Botuara nga ATK	Ueb faqja e ATK-së	Zbatuar
1.2.20 Plotësim ndryshimi i Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat	K3 2019	Buxh.	<b>MF/</b> <b>ATK</b>	Ligji i aprovuar në Qeveri	Ueb faqja e ATK-së	Pazbatuar
<b>Objektivi Specifik I.3: Përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.</b>						
1.3.1 Përditësimi i vazhdueshëm i klasifikimit të aktivitetit ekonomik të bizneseve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE rev.2) dhe shkëmbimi i këtyre informacioneve në mes të ARKBK-së, ATK-së dhe ASK-së	K2 2019 dhe vazhdueshëm	Buxh.	<b>ARBK/</b> <b>ATK;</b> <b>ASK</b>	Klasifikimi i aktivitetit ekonomik të bizneseve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE Rev.2)		Zbatuar
1.3.2 Intensifikimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes ATK dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e punëtorëve të pa regjistruar, duke u bazuar në të dhënat e marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në publikimin e anketave të ekonomisë joformale	K1 2020 Vazhdueshëm	Buxh.	<b>MPMS;</b> <b>ATK</b>	- Kontrollë nga Inspektorati i Punës - Regjistrim vullnetar dhe i detyruar i punonjësve nga subjektet e aktivitetit ekonomik - Formate të shkëmbimit të të dhënave midis MPMS, ATK dhe ASK	MPMS; ATK Respektivisht Faqet e tyre te internetit me informacione dhe statistikat përkatëse	Në proces
1.3.3 Arritja e një memorandumi të mirëkuptimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe MF/ATK për të siguruar shkëmbimin e të dhënave nga noterët për transaksionet i) Në patundshmëri ii) Makina iii) Qira, i cili si	K1 2020	Buxh.	<b>MD;</b> <b>MF/ATK</b>	Dokumenti i Memorandumit i Miratuar dhe Publikuar në faqen		Pazbatuar

minimum të ofrojë informacion mbi numrin e transaksioneve, tipin (blerje, transferim, qira), adresën, vlerën, subjektin (person fizik, biznes apo publik)				zyrtare të MD-së dhe MF-së		
1.3.4 Zhvillimi dhe prezantimi i moduleve të reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat në sektorë	K1 2020	Don.	<b>MF</b>	-Plani i Veprimit për modulet e reja i aprovuar deri në K4 2019	PVPMF 2019, SRMFP 2019-2020	Pazbatuar
1.3.5 Publikimi dhe përditësimi i listës së High Risk Countries (sipas publikimeve të FATF), Lista e Zezë EU, OECD Lista e GoldPassports 2018 etj.	Vazhdueshëm	-	<b>NJIF</b>	Lista e Vendeve të Rrezikshme e përditësuar çdo 6 mujor dhe shpërndarë autoriteteve relevante	Raportet Vjetore të Punës të NJIF	Zbatuar
1.3.6 Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të Rrezikut NJIF sipas rekomandimeve të vlerësimeve dhe asistencës teknike në këtë fushë	K4 2019	Buxh.	<b>NJIF</b>	-Lista e konsoliduar e Rekomandimeve deri në K2 2019. - Metodologjia e përditësuar me rekomandimet e dakortesuara deri në K4 2019	Raportet Vjetore të Punës të NJIF	Në proces
1.3.7 Rritja e veprimeve të koordinuara (kontroll/inspektim) të NJIF dhe organeve të zbatimit të ligjit në bizneset me rrezik të lartë, pjesë e listës së identifikuar nga NJIF	K2 2019 dhe vazhdueshëm	Buxh.	<b>NJIF;</b> <b>PK;</b> <b>ATK;</b> <b>DK</b>	Kontrolle dhe Inspektime të koordinuara (20% rritje nga viti në vit)		Zbatuar
1.3.8 Rritja e inspektiveve dhe aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në zyrat noteriale dhe agjencitë e paluajtshmërive, për të vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me Ligjin për PPP dhe FT	K4 2019-2022	Buxh.	<b>NJIF</b>	Kontrolle dhe Inspektime (për tu specifikuar numri në krahasim me aktualin)		Në proces
1.3.9 Të sigurohet bashkëpunimi funksional nga Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës me Administratat e huaja tatimore dhe Doganore përmes nënshkrimit të MM-ve,	K4 2019-2022	Buxh.	<b>MF/ATK;</b> <b>DK</b>	Numri i Marrëveshjeve të nënshkruara.		Në proces

për forcimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të informacionit e veçanërisht lidhur me kompaninë amë apo kompaninë e linjës						
1.3.10 Të rritet cilësia e monitorimit dhe procedurave penale të ndërtimeve për të zvogëluar ndërtimin e kundërligjshëm dhe ndërtimin e ndërtesave që nuk i përmbushin specifikacionet e kërkuara	K2 2020-2022	Buxh.	<b>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH); MF/Departamenti i Tatimit ne Prone; Komunat</b>	-Plani i Veprimit për të zbatuar masën. -Metodologjia e Kontrollit dhe monitorimit e përditësuar -Raportimi mbi masën dhe rezultatet në krahasim me aktualin		Në proces
1.3.11 Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve në Divizionin e Ekonomisë joformale dhe llogarive qeveritare	K4 2019 dhe vazhdueshëm	Don.	<b>ASK</b>	Numri i Trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit		Në proces
1.3.12 Trajnimi për “Forecast consolidation” të Divizionit të Politikave Fiskale për “Tax Expenditures and Impact Assessment”	K4 2019- 2022	Don.	<b>MF</b>	-Metodologjia e Aplikuar e komentuar dhe rishikuar nga FMN -Numri i Trajnimeve - -Metodologjia e aprovuar pas rekomandimeve dhe komenteve të Donatorëve	Raporti Vjetor i Punës MF	Pazbatuar
<b>Objektivi Specifik I. 4: Zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë</b>						
1.4.5 Përgatitja e udhëzuesit për metodologjinë evlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë së rasteve/prioritizimi dhe vendosja e planit të inspektimit dhe trajnimi i stafit përkatës për përdorimin e metodologjisë	T1 2020	Don:	<b>MPMS, ATK</b>	Udhëzuesi i finalizuar dhe stafi i trajnuar për zbatimin e udhëzuesit.	SKZH 2016 - 2020: Shtylla 1, Kapitali Njerëzor - Ulja e nivelit të punësimit joformal	Zbatuar

1.4.7 Ndërtimi i një sistemi monitorues dhe sistemi për vlerësimin e performancës sëpunës së inspektorëve	Nuk ka kosto shtesë. Kosto e përfshirë në Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale, Aktiviteti 3 në kuadër të Objektivës Specifike 2.2	Nuk ka kosto shtesë, është e kostuar në Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale 2018 -2022, aktiviteti 6 në kuadër të Objektivës Specifike	<b>MPMS, ATK</b>	Sistemi monitorues dhe vlerësues i finalizuar dhe funksional. Staf i trajnuar	SKZH 2016 - 2020: Shtylla 1, Kapitali Njerëzor - Ulja e nivelit të punësimit joformal	Në proces
1.4.8 Trajnime për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve	T4 2019	Nuk ka kosto shtesë, aktivitetet e kostuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale 2018-2022. Aktivitet 1; 5 në kuadër të Objektivës Specifike	<b>MPMS</b>	80 inspektorë të punës të trajnuar	SKZH2016 - 2020: Shtylla 1, Kapitali Njerëzor - Ulja e nivelit të punësimit joformal	Në proces
1.4.9 Funksionalizimi/ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave	T4 2019	Don.	<b>MPMS</b>	Sistemi i ndërtuar dhe funksional, 80 tabletë të blerë dhe inspektorët e punës të trajnuar.	SKZH 2016-2020: Shtylla 1, Kapitali Njerëzor - Ulja e nivelit	Në proces



					të punësimit joformal	
1.4.10 Pajisja e inspektorëve me mjete pune	T4 2019	Buxh.	<b>MPMS</b>	40 inspektorë të punës pajisen me kompjuterë.	SKZH 2016-2020: Shtylla 1, Kapitali Njerëzor - Ulja e nivelit të punësimit joformal	Pazbatuar
1.4.11 Pajisja e inspektorëve me vetura	T4 2019, 2020 dhe 2021	Buxh.	<b>MPMS</b>	Inspektorët e punës pajisen me 6 vetura.	SKZH 2016-2020: Shtylla 1, Kapitali Njerëzor - Ulja e nivelit të punësimit joformal	Pazbatuar
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK II: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.</b>						
<b>Objektivi specifik II.1: Përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.</b>						
2.1.1 Kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektiv ekonominë joformale (Impact Assessments)	K4 2019 - 2022	Don.	<b>MF</b>	Vlerësimet e Impaktit të masave të planifikuara të botuara si pjesë e botimeve të i)Projekt Buxhetit dhe ii)dokumentit të rrezikut për Projekt Buxhetin iii) dokumentit të Reformave Ekonomike	Faqja Ueb e MF	Pazbatuar

2.1.2 Kryerja e studimeve apo vlerësimeve në fushën e ekonomisë joformale sipas standardeve ndërkombëtare lidhur me hendekun tatimor	K4 2019 - 2022	Buxh. Don.	MF; ATK; MPMS; ASK	-Plani i Studimeve të Publikuara -Raporti mbi Studimet e Kryera - Statistikat përkatëse në fund të çdo viti të vendosura në faqen zyrtare të MF		Pazbatuar
<b>Objektivi Specifik II.2: Rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.</b>						
2.2.1 Ulja e pragut lidhur me transaksionet në mes bizneseve të cilat bëhen në kesh (aktualisht 500 EUR)	K1 2020		MF/ATK	Ligji i ri për Administratën Tatimore dhe procedurat – i aprovuar		Pazbatuar
2.2.2 Dizajnimi i Softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me numrin e kuponëve fiskal të lëshuar, kohën dhe artikujt në kohë reale (online)	K2 2020	Buxh.	ATK	- Termat e Referencës për Shërbimin K2 2019 - Kontraktimi i Kompanisë së Shërbimit K2 2019 - Zhvillimi dhe Testimi i Softuerëve deri në K4 2019 - Vënia në zbatim dhe operimi në të gjitha kasat fiskale deri në fund të K2 2020		Pazbatuar
<b>Objektivi Specifik II.3: Përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.</b>						
2.3.1 Rishikimi i formave standarde për shkëmbim të dhënave elektronike dhe në bartës fizik me qëllim shkurtime të kohës së rrjedhës së informacionit në komunikimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar	K4 2019	Buxh. Don.	MAP/MD; PK; ATK; DK; NJIF	Instruksioni mbi Institucionin Udhëheqës gati dhe i raportuar në Sekretariat deri në K2 2019	Ministria e Administrimit Publik. Rishikime të Ligjit të Procedurës Administrative	Zbatuar

2.3.2 Publikimi i Tabelës Ofruese/Përdoruese nga ASK	K2 2020	Don.	<b>ASK</b>	-Publikimi i tabelës Burime/Përdorimi nga ASK.	Faqja zyrtare e ASK	Në proces
2.3.3 Përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal	K4 2020	Don.	<b>MF</b>	Instalimi i moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal.		Pazbatuar
2.3.4 Zgjerimi i inspektimeve në sektorin e ndërtimitarisë dhe OJQ-ve lidhur me FT (Financimi i Terrorizmit) dhe PP (Pastrimi i Parave), ku inspektimet tek subjektet e caktuara që paraqesin rrezik më të lartë, të bazohen në inteligjencën financiare, tatimore dhe kriminale (Target të jetë sektori i ndërtimitarisë)	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>NJIF/ ATK, PK</b>	- Udhëzuesi përkatës i miratuar dhe në zbatim - Plani i Inspektimeve - Raportimi çdo vit në kuadër të zbatimit të Strategjisë		Në proces
2.3.5 Krijimi i grupeve të përbashkëta në mes të DK dhe ATK me qëllim kontrollin e mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangiesë taksave	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>DK; ATK</b>	- Kontrollat e Realizuara - Tatimpagues të kontrolluar		Zbatuar
2.3.6 Hetimi dhe realizimi i operacioneve të përbashkëta me qëllim luftimin e kontrabandës së mallrave	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>PK; DK; Prokuroria</b>	- Numri i hetimeve të përbashkëta	Raporti i Punës i PK	Zbatuar
2.3.7 Rritja e aktiviteteve të ndërmarra në parandalimin e mallrave që shkelin të drejtë pronësisë Intelektuale – IPR	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>DK</b>	Rritja e numrit të aktiviteteve në raport me vitin paraprak	Strategjia e Doganës së Kosovës 2019-2023	Zbatuar
2.3.8 Rritja e numrit të patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>DK</b>	Rritja e numrit të patrullimeve në raport me vitin paraprak	Strategjia e Doganës së Kosovës 2019-2023	Zbatuar


2.3.9 Aplikimi i kontrolleve pas importuese në bazë të menaxhimit të rrezikut dhe informacioneve tjera	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>DK</b>	Rritja e numrit te aktiviteteve në raport me vitin paraprak	Strategjia e Doganës së Kosovës 2019-2023	Zbatuar
2.3.10 Trajnime për ATK-në në fushën e menaxhimit të rrezikut	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>ATK</b>	Trajnime të realizuara		Zbatuar
2.3.11 Trajnim për Doganat e Kosovës në fushën ezbatimit të Ligjit	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>DK</b>	Trajnime të realizuara	Plani i Veprimit 2019	Zbatuar
2.3.12 Trajnime të dedikuara profesionalizmi të Prokurorëve për veprën penale të krimit ekonomik dhe pastrimin e parave	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>Prokuroria</b>	Trajnime të realizuara		Zbatuar
2.3.13 Organizimi i trajnimeve për institucionet që monitorojnë aktivitetet në sektorin e ndërtimtarisë mbi PP/FT, lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet tjera financiare, posaçërisht në sektorin e ndërtimtarisë dhe patundshmërive (auditorët dhe inspektorët)	K4 2019- 2022	Buxh.	<b>NJIF</b>	Jo më pak se 1 trajnim në vit me të paktën 30 pjesëmarrës. Materiale trajnimesh dhe prezantime		Zbatuar
2.3.14 Ngritja e aftësive profesionale në fushën e PP/FT për Prokurorët, Gjyqtarët, Hetuesit dhe Inteligjenca Financiare	K4 2019 - 2022	Buxh.	<b>NJIF/ PK; MD; Prokuroria</b>	Jo më pak se 3 trajnime në vit me të paktën 30 pjesëmarrës. Materiale trajnimesh dhe prezantime.		Zbatuar

## Objektivi Strategjik I

Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përmes aktiviteteve të këtij objektivi synohet të bëhet korigjimi i problemit të dëmtimit të cilësisë së qeverisjes ekonomike për shkak të ekonomisë joformale të shprehur si prani e konkurrencës së padrejtë, pabarazi, moszbatim i kontratave, prani e artikujve të kontrabandës dhe punësim joformal me të drejta të pakta të të punësuarve.

Në kuadër të këtij objektivi janë planifikuar gjithsej pesëdhjetë e tre (53) aktivitete të ndara në katër (4) objektiva specifikë, nga të cilat njëzetë (20) apo 38% prej tyre janë zbatuar, njëzetë (20) apo 38% të tjera janë në proces të zbatimit, kurse trembëdhjetë (13) apo 25% prej tyre nuk janë zbatuar.

**Grafiku 2:** Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik I



*Burimi: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*

Në **Objektivin specifik 1.1** është synuar përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.

Ky objektivi përmban gjithsej dhjetë (10) aktivitete, pesë (5) apo 50% prej të cilave janë zbatuar, tre (3) apo 30% janë në proces të zbatimit, ndërsa dy (2) apo 20% e tyre nuk janë zbatuar.

Gjatë përpilimit të parashikimeve makro-fiskale, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve vazhdimisht përdorë të dhënat e anketave statistikore të publikuara nga ASK-ja. Vlerësimi i hendekut tatimor i realizuar me asistencë teknike të Bankës Botërore është bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjeve të ASK-së për periudhën 2015-2017, po ashtu hartimi i buletinëve tremujorë dhe dokumenteve

tjera të publikuara në faqen e MFPT të përgatitura nga Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar përdorin të dhënat e publikuara nga ASK.

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka shënuar progres lidhur me përpilimin e të dhënave të ekonomisë joformale në harmoni të plotë me metodologjinë dhe standardet ndërkombëtare, duke përfshirë implementimin e metodologjisë së Eurostatit dhe OECD-së për komponentët në vijim: vlerësimi i ekonomisë joformale sipas kontrolleve fiskale të ATK-së; vlerësimi i ekonomisë joformale sipas Metodës së Inputit të Punës (LIM); vlerësimi i trafikimit të drogës; vlerësimi i ekonomisë joformale për llojin N6 – keqraportimi i numrit të të vetëpunësuarve, etj. Ndërsa, për shkak të pandemisë dhe mungesës së stafit nuk është realizuar ndonjë aktivitet konkret lidhur me realizimin e Anketës për çmimet e tokës bujqësore nga ASK.

MFPT ka përgatitur me sukses udhëzuesin mbi Metodologjinë e Vlerësimit të impaktit të ndryshimeve tatimore (Tax Expenditure) dhe ka kërkuar asistencë teknike për zbatimin e tij para miratimit të çdo mase fiskale të propozuar. Poashtu, MFPT ka krijuar kodet në planin kontabël në të cilin identifikohen llojet e të hyrave të cekura në aktivitetet, përkatësisht për gjoba, ndëshkim, interes, shmangie tatimore dhe lloj tatimi.

Banka Qendrore e Kosovës ka vazhduar me realizimin e funksionit mbikëqyrës në institucionet financiare sa i përket pajtueshmërisë me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke i realizuar gjithsej shtatë ekzaminime (dy ekzaminime të plota në institucionet bankare dhe katër ekzaminime në institucionet mikrofinanciare dhe ato jo bankare: dy të fokusuara dhe dy të plota). Ndërsa siguresit janë mbuluar me një ekzaminim të plotë.

Poashtu, BQK ka rritur mbikëqyrjen për përshkrimin e transaksioneve financiare nga bankat në mënyrë që të rritet dobia e informacionit për analiza cilësore në organet përkatëse në pajtueshmëri me Udhëzimin për përdorimin e formularit mbi prejardhjen e fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të pronësisë përfituese.

Sa i përket krijimit të një sistemi ndër bankar të pagesave me qëllim të stimulimit të pagesave me kartelë dhe formave të tjera të pagesave duke zvogëluar në masë përdorimin e kesh-it si mjet pagese, është iniciuar studimi i fizibilitetit, i cili është duke u kryer nga Banka Botërore me qëllim të identifikimit të zgjidhjeve të mundshme për krijimin e një sistemi të pagesave të shpejta.

Ndërsa lidhur me dhënien e Kredive bankare bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në ATK dhe të certifikuara nga ekspertët e lëmisë për të gjitha bizneset që janë të obliguara të dorëzojnë pasqyrat në këtë institucion, BQK ka përditësuar Rregulloren për Regjistrin e Kredive të aprovuar nga Bordi në Shtator 2019, ku lejohet mbledhja e të dhënave alternative përfshirë të dhënat nga ATK. Në mënyrë që të finalizohet si projekt kërkohen zhvillime në sistemin e Regjistrit të Kredive, të cilat janë planifikuar të realizohen gjatë vitit 2023.

Ndërsa nuk është raportuar progres në publikimin e të dhënave të fushës së financave publike në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura.

Njësia e Inteligjencës Financiare gjatë vitit 2022 ka prioritzuar vlerësimet e sektorëve në vijim: Vlerësimi i Riskut të pastrimit të parave nëpërmjet produkteve bankare të ofruara në Kosovë dhe OJQ-të. Vlerësimi i Riskut të pastrimit të parave nëpërmjet produkteve bankare të ofruara në Kosovë është

inicuar në K2 2022 dhe do të zhvillohet gjatë kësaj periudhe: Maj 2022 - Dhjetor 2022/Mars 2023. Vlerësimi i Rrezikut Specifik Sektorial për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit për OJQ-të do të zhvillohet gjatë periudhës dhjetor 2022 - gusht 2023.

**Në Objektivin specifik 1.2** është synuar rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej njëzetë (20) aktivitete, gjashtë (6) apo 30% prej të cilave janë zbatuar, tetë (8) apo 40% janë në proces të zbatimit, ndërsa gjashtë (6) apo 30% e tyre nuk janë zbatuar.

Lidhur me rritjen e aktiviteteve të komunikimit me publikun për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të qytetarëve nga organet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare, MFPT nuk ka publikuar ende raporte gjashtëmujore për zbatimin e SLEJ 2019-2023. Megjithatë, Dogana e Kosovës ka rritur numrin e publikimeve (mbi 350) përmes kanaleve zyrtare dhe rrjeteve sociale. Është publikuar aplikacioni për telefona të mençur i cili u mundëson qytetarëve dhe i fton ata të jenë pjesë aktive e parandalimit dhe raportimit të korrupsionit, kontrabandës dhe parregullsive tjera. Janë mbajtur pesë (5) aktivitete vetëdijesuese në fushën e Pronësisë Intelektuale si dhe ka pasur prezencë në emisione televizive lidhur me ndërgjegjësimin e publikut dhe për të promovuar luftën kundër piraterisë dhe produkteve të falsifikuara.

Lidhur me rritjen e numrit të konferencave, punëtorive dhe takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale për të diskutuar ndikimin e masave të luftës kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare, institucionet përgjegjëse kanë vazhduar me zbatimin e aktivitetit. Dogana e Kosovës ka mbajtur tridhjetë e tre (33) takime me biznese të ndryshme, Shoqatën e Shpeditoreve, Odën e Afarizmit të Kosovës, Odën Ekonomike Gjermane, takime këto në përkrahje të bizneseve në deklarin vullnetar, zbatimin ligjor dhe efikas të obligimeve doganore.

NJIF-K ka marrë pjesë në shtatë (7) takime të Egmont Group: "Takimet e Grupeve Punuese dhe Rajonale të Egmont 2022"; Më 19 janar është mbajtur punëtorja e Projektit CRAAFT (ftesë në punëtori - GLOBSEC) me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor me fokus në vlerësimin e kërcënimit të terrorizmit dhe financimin e terrorizmit, bashkëpunimin ndërkombëtar të IFN-ve; Më 27 janar 2022 është mbajtur takim me Agjencinë Kombëtare të Krimit të Mbretërisë së Bashkuar; Më 16 shkurt 2022 takim me praktikantët e magistraturës franceze - Raport mbi korrupsionin; Më 3 mars 2022 takimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor i organizuar nga Transparency International-Maqedonia me temën "Lufta kundër flukseve të paligjshme financiare "Si i respektojnë rregullat kundër pastrimit të parave dhe mbrojtjen e të dhënave". Më 17 mars 2022 punëtori me përfaqësuesit e Shoqatës së OJV-ve me temën "OJF dhe rreziqet e PPP/LFT", organizuar nga Projekti kundër krimit ekonomik (PECK III); Më 09 qershor 2022 takim me përfaqësuesit e Shoqatës së avokatëve dhe ndërmjetësuesve me temën "Koordinimi ndër-institucional në ndërmjetësim".

Ngecje ka pasur lidhur me pasqyrimin e të ardhurave nga ekonomia joformale gri dhe e zezë në raportin vjetor të zbatimit të Strategjisë Kombëtare, megjithatë të hyrat e përgjithshme doganore për periudhën janar - qershor 2022 janë rritur për 77.6 milion EUR ose shprehur në përqindje 12.9% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nga gjithsej të hyrat e përgjithshme doganore, Dogana e Kosovës ka evidentuar rreth 10.9 milion EUR të hyra nga aktivitetet e luftimit të ekonomisë joformale, duke përfshirë: të hyrat nga rivlerësimi i mallrave 9,995,500.00 EUR, të hyrat nga kundërvajtjet dhe dënimet

677,644.23 EUR, të hyrat nga mosdeklarimi i mjeteve monetare 117,122.57 EUR dhe të hyrat nga shitja e mallrave të konfiskuara 99,691.58 EUR.

Sa i përket përgatitjes dhe publikimit të fletëpalosjes me informacion për publikun rreth efektit të pritur në parandalimin e ekonomisë joformale nga zbatimi i masave të parapara sipas nenit 64 të MSA mbi sistemet e Pagesave, Banka Qendrore e Kosovës ka zbatuar publikimin e materialeve informative mbi sistemet dhe instrumentet e pagesave. Gjithashtu, BQK është në proces të amendamentimit të Ligjit për Sistemin e Pagesave në funksion të transpozimit të direktivës së Bashkimit Evropian për Shërbimet e Pagesave, që njihet si PSD2 dhe direktivës së Bashkimit Evropian për institucionet e parave elektronike, që njihet si EMD. Me amendamentimin e Ligjit të Sistemit të Pagesave dhe implementimin e kërkesave të këtyre dy direktivave pritet që të rritet konkurrenca në shërbimet e pagesave përmes mundësisë të hyrjes në treg të shërbimeve të reja të ofruara nga institucionet financiare jo-banka të autorizuara për shërbimet e pagesave si dhe të krijohen mundësi për rritjen e interoperabilitetit ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave (banka dhe jobanka) përmes mundësisë të bankingut të hapur (open banking) të obliguar ligjërisht. Me këtë rast do të ndikohet në rritjen e efikasitetit të shërbimeve të pagesave elektronike, gjë që mund të ndikojë në uljen e përdorimit të pagesave me para në të gatshme.

Progresi ka munguar në studimin e procesit të vlerësimit të çmimit të pronës, regjistrimit të patundshmërive në rast blerjeje për herë të parë apo transferimi në mënyrë që vlera e asetit të regjistruar të pasqyrojë vlerën aktuale të tregut.

Ndërsa, projekti i unifikimit të adresave është në proces. Gjatë periudhës raportuese janë hartuar Termat e Referencës për angazhimin e 55 konsulentëve që të ndihmojnë Komunitatet në azhurnimin e të dhënave për Sistemin e Adresave në aplikacionin ARIS. Janë angazhuar katër (4) konsulentë në Asociacionin e Komuniteteve të Kosovës për të ndihmuar Njësinë e Adresave për menaxhimin e aktiviteteve për sistemin e adresave. Janë përgatitur edhe specifikat teknike për vendosjen e tabelave të rrugëve dhe numrat e objekteve për Komunitatet e mbetura. Me iniciativë të Zyrës së Kryeministrit dhe përkrahje të GIZ, është duke u implementuar pilot projekti për lidhjen e adresave me regjistrin civil në Komunitatet Istog dhe Mitrovicë e Jugut. Rezultatet e këtij pilot projekti do të shërbejnë për lidhjen e adresave me regjistrin civil në të gjitha Komunitatet tjera.

Në kuadër të infrastrukturës ligjore janë formuar grupet punuese për hartimin e koncepteve të cilat si synim kanë dorëzimin e deklaratës vjetore personale dhe familjare në ATK edhe nga personat fizikë jo afarist, mirëpo për shkak të pandemisë ende nuk është përfunduar puna në këtë drejtim.

Sfidë për luftimin e ekonomisë joformale mbetet pagesa e të punësuarve përmes bankës. Në këtë drejtim, puna e padeklaruar vazhdon të jetë faktori kyq në mosrealizimin e plotë të këtij qëllimi.

Në anën tjetër, Administrata Tatimore e Kosovës ka vazhduar me pajisjen e bizneseve me arkë fiskale, ku numri i bizneseve që posedojnë arka fiskale është gjithnjë në rritje. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar 690 vizita tek bizneset e pafiskalizuar, ku janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 30,125 EUR. Janë realizuar 1,213 vizita tek bizneset të cilat nuk lëshojnë kuponë fiskal, me ç'rast janë shqiptuar 712 gjoba mandatore në shumën prej 295,875 EUR. Ndërsa sa i përket fiskalizimit, gjatë periudhës raportuese janë fiskalizuar 2,020 biznese, ndërsa janë instaluar 2,661 pajisje fiskale.



Po ashtu, ATK është në proces të implementimit të faturës elektronike. Gjatë kësaj periudhe është përfunduar me zhvillimin dhe testimin e sistemit softuerik. Janë certifikuar gjashtë (6) modele të Pajisjeve Elektronike Fiskale. Instalimi i Pajisjeve Elektronike Fiskale të reja tek Tatimpaguesi ka filluar në dhjetor 2021 dhe deri më tani janë instaluar 3,032 PEF tek 2,551 biznese.

Lidhur me plotësim/ndryshimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dhënë komentet në lidhje me draft Ligjin në fjalë dhe aktiviteti është në proces.

Ndërsa, sa i përket auditimit të pavarur të financave të partive politike, gjatë periudhës raportuese për këtë aktivitet ishte përgjegjës Kuvendi, përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Aktiviteti është në proces dhe rezultati përfundimtar mund të arrihet në gjashtëmuorin e dytë 2022 nga KQZ, meqenëse kjo përgjegjësi ka kaluar në KQZ.

Lidhur me Njësine për Rikthimin e Aseteve të Konfiskuara, në kuadër të Policisë së Kosovës, konkretisht brenda strukturës së Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, ekziston Zyra për Rikthim të Pasurisë (aseteve). Kjo zyrë është themeluar në vitin 2018 dhe merret me trajtimin e rasteve/kërkesave ndërkombëtare përmes ILECU-së, kërkesat e organizatës ndërkombëtare Carin si dhe ndihmat ndërkombëtare Juridike përmes Autorizimeve të Prokurorisë për identifikimin e asetëve. Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar gjithsej gjashtë (6) kërkesa nga shtete të ndryshme dhe dy (2) Autorizime nga Prokuroritë kompetente.

Ndërsa, lidhur me krijimin e fondit të konfiskimit, gjatë periudhës raportuese Ministria e Drejtësisë ka vazhduar punën me hartimin dhe finalizimin e Koncept Dokumentit për krijimin e fondit të konfiskimit. Ky Koncept Dokument u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 23 qershor 2022. Sipas Opsionit të rekomanduar në këtë Koncept Dokument, do të ndryshohet/plotësohet Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK) si dhe Ligji Vjetor për buxhetin.

Përgjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit kanë zhvilluar hetime në fushën e krimeve financiare të cilat kanë rezultuar në ngritjen e aktakuzave si dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale në përputhje me rekomandimet e FATF-së. Policia e Kosovës në të gjitha rastet ku dyshohet për përfitim të kundërligjshëm të pasurisë zhvillon edhe hetime financiare. Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar hetime për njëzetë e një (21) raste. Policia e Kosovës së fundmi i kushton rëndësi të madhe hetimeve paralele financiare në rastet të cilat i heton. Gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar hetime financiare paralele në tri (3) raste. Ndërsa, Prokuroria e Shtetit ka vazhduar me aktivitetet e saj, ku gjatë periudhës raportuese janë gjithsej njëzetë e tre (23) raste të konfiskimit në vlerë përfundimisht të konfiskuar prej 417,239.49 EUR. Sa i përket sekuestrimit janë 176 raste të raportuara dhe vlera e ngrirjes dhe sekuestrimit është gjithsej 9,737,777.04 EUR.

Lidhur me shtimin e aktiviteteve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë siç është e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës, institucionet përgjegjëse kanë zbatuar me sukses aktivitetet e tyre si në vijim:

Policia e Kosovës - Bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale që lidhen me Krime Ekonomike janë: Kapitulli XXV veprat penale kundër ekonomisë me tridhjetë e katër (34) vepra penale, Kapitulli XXVI veprat penale kundër pasurisë me pesë (5) vepra penale, Kapitulli XXXI veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike me dy (2) vepra penale, Kapitulli XXXIII

Korrupsioni zyrtar dhe Veprat penale kundër detyrës zyrtare me katërbëdhjetë (14) vepra penale, pra gjithsej pesëdhjetë e pesë (55) vepra penale.

Prokuroria e Shtetit - Veprat penale të Krimeve Ekonomike - Prokuroritë gjatë periudhës raportuese kanë pranuar dhe regjistruar gjithsej 177 raste penale me 262 persona të përfshirë në veprat penale të Krimeve ekonomike dhe kanë ndërmarrë 141 veprime/vendime për rastet e personave të përfshirë në veprat penale të grupit të Krimeve ekonomike. Vepra Penale Shpërlarje e parasë - Prokuroria Speciale ka pranuar pesë (5) raste penale me nëntë (9) persona për veprën penale të Shpërlarjes së parasë dhe ka ndërmarrë shtatë (7) veprime/vendime në kuadër të trajtimit të rasteve për personat e përfshirë në veprën penale të Shpërlarjes së parasë. Vepra penale e Drogave - Prokuroritë kanë pranuar 607 kallëzime penale me 756 persona të përfshirë në veprat penale të Drogave dhe kanë ndërmarrë 334 veprime/vendime në kuadër të trajtimit të rasteve për personat e përfshirë në veprat penale të Drogave. Vepra penale Krim i organizuar - Prokuroria Speciale ka pranuar pesë (5) raste penale me gjashtëdhjetë e pesë (65) persona të përfshirë në veprën penale të Krimit të organizuar dhe ka marrë tetëdhjetë e tetë (85) veprime/vendime në kuadër të trajtimit të rasteve për personat e përfshirë në veprën penale të Krimit të organizuar. Vepra penale Korrupsioni - Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale kanë parashtruar nëpër prokurori 226 raste penale me 355 persona të përfshirë në veprat penale Korrupsioni dhe kanë ndërmarrë 113 veprime/vendime në kuadër të trajtimit të rasteve për personat e përfshirë në rastet penale për veprën penale të Korrupsionit.

Dogana e Kosovës - Në fushën e hetimit doganor janë iniciuar tridhjetë e tetë (38) raste të reja për hetime dhe janë dorëzuar njezetë e pesë (25) kallëzime penale me gjithsej tridhjetë e shtatë (37) persona të kallëzuar pranë prokurorive përgjegjëse, ku janë siguruar prova të mjaftueshme se kemi të bëjmë me shmangie nga detyrimet doganore në vlerë prej 1.25 milion EUR si dhe janë sekuestruar mallra në vlerë prej 829 mijë EUR.

Administrata Tatimore e Kosovës - ATK ka vazhduar me trajtimin dhe hetimin e rasteve të cilat ndërlidhen me shmangie tatimore me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve tek bizneset dhe individët të cilët si veprimtari të tyre kanë: restorantet, veprimtaritë argëtuese – estrada, sallonet e ondulimit dhe shërbimet tjera të cilat ndërlidhen me këto veprimtari, aktivitete të cilat do të ndërmerren pas fillimit të sezonit veror. Aktivitetet e ATK-së gjatë periudhës raportuese janë si në vijim: njezetë e tre (23) aktivitete për shmangie tatimore; dhjetë (10) raste të hapura nën dyshimin e shmangies tatimore; dhjetë (10) Raporte të dyshimit fillestar (kallëzim penal), njëmbëdhjetë (11) Raporte finale Hetuese, katërdhjetë e nëntë (49) Raporte informuese për Prokurori, 126 intervista (deklarata) me të dyshuar dhe dëshmitarë, 115 informata për institucionet e zbatimit të ligjit. Po ashtu gjatë kësaj periudhe evazioni tatimor pa ndëshkime dhe interes ishte në vlerë prej 2,354,388.39 EUR, ndërsa tatim shtesë (pa ndëshkime dhe interes) prej 1,661,550.15 EUR zbritje të kreditimit prej 27,876.02 EUR si dhe zvogëlim të humbjeve prej 38,150.00 EUR.

Sa i përket Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit në përputhje me praktikat e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vendit 2018 për Kosovën dhe MSA (Neni 89) ka pasur vonesa, megjithatë Koncept Dokumenti është në hartim e sipër. Në muajin mars 2022 është mbajtur takimi i Grupit Punues ku është zhvilluar drafti i fundit i Koncept Dokumentit si dhe prezantimi i rekomandimeve të ekspertit të Këshillit të Evropës lidhur me zhvillimet e reja nga fusha e PP/LFT dhe përafrimi i Koncept Dokumentit me Direktivat e BE-së. Në qershor 2022 dokumenti është finalizuar dhe rishikuar nga eksperti ndërkombëtar i PECK III. Pas përkthimit në gjuhët zyrtare do të dërgohet për finalizim tek grupi punues dhe pastaj do të lëshohet në konsultime publike.

Në anën tjetër, ATK ka vazhduar me rritjen e numrit të vizitave dhe kontrolleve bazuar në vlerësimet e rrezikut, ku ka realizuar 18,866 vizita në të gjitha rajonet. Si rezultat i vizitave janë lëshuar 4,998 gjoba mandatore në vlerë prej 1,569,710.00 EUR, tatim shtesë në vlerë prej 5.7 milion EUR, ulje të kreditimit të TVSH-së në vlerë prej 3.8 milion EUR dhe zvogëlim të humbjes prej 5.4 milion EUR. Ndërsa sa i përket kontrolleve për këtë periudhë janë realizuar 894 kontrole, me këto rezultate: rreth 17.7 milion EUR tatim shtesë (përfshirë tatimi bazë, interesi dhe ndëshkimi), 7.7 milion EUR kreditim i zbritur dhe mbi 19.2 milion EUR humbje të zbritur. Numri i kontrolleve të realizuara të bazuara në risk për periudhën janar-qershor 2022 është 60% më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i vizitave të realizuara të bazuara në risk është 29% më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Ndërsa, janë bërë të gjitha plotësim-ndryshimet për Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, mirëpo i njëjti nuk është aprovuar ende nga Kuvendi.

**Në Objektivin specifik 1.3** është synuar përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimi për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete, tre (3) apo 25% prej të cilave janë zbatuar, gjashtë (6) apo 50% janë në proces të zbatimit, ndërsa tre (3) apo 25% të tjera nuk janë zbatuar.

Bizneset në vend edhe gjatë periudhës raportuese kanë vazhduar me përditësimin dhe klasifikimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE rev.2) dhe po ashtu ka vazhduar shkëmbimi i këtyre informatave ndërmjet ARBK-së, ATK-së dhe ASK-së.

Sa i përket intensifikimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në mes të ATK-së dhe ish MPMS-së me qëllim të identifikimit dhe regjistrimit të punëtorëve të pa regjistruar, gjatë periudhës raportuese Inspektorati i Punës ka mbajtur një takim me ATK-në me qëllim të vendosjes së raporteve mes dy institucioneve, përfshirë caktimin e dy (2) personave përgjegjës si pika kontaktuese, koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta në terren rreth projektit të punësimit joformal, shkëmbimin e përvojave dhe informatave në lidhje me rastet me rrezik të lartë dhe harmonizimin e të dhënave rreth nivelit të punësimit joformal.

Ndërsa, ende nuk është arritur memorandumi i mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe MFPT/ATK për të siguruar shkëmbimin e të dhënave nga noterët për transaksionet në patundshmëri, makina dhe qera, i cili si minimum të ofrojë informacion mbi numrin e transaksioneve, tipin, adresën, vlerën dhe subjektin.

Gjatë periudhës raportuese nuk është arritur të zhvillohen dhe prezantohen as modulet e reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat nëpër sektorë. Pandemia ishte pengesa kryesore në moszbatimin e aktivitetit, së bashku me qarkullimin e madh të stafit gjatë vitit 2021 në Divizionin e Makroekonomisë. Dhe duke qenë se për prezantimin e modeleve të reja nevojitet që stafi i ri fillimisht të njihet plotësisht me modelin ekzistues si dhe me kursin online të Parashikimit të të Ardhurave të FMN-së e pastaj të vazhdoj me hapat përgatitor të zhvillimit të kornizave të reja të parashikimit të zërave të të ardhurave specifike për sektorin, gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur zbatim të aktivitetit.

Në anën tjetër, më 23 maj 2022 është përditësuar lista e vendeve me rrezik të lartë (sipas publikimeve të FATF).

Gjatë periudhës raportuese, po ashtu është hartuar dhe miratuar Metodologjia "Mjetet për Vlerësimin e Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Personave Juridikë për Kosovën" nga NJIF. Për më tepër, do të hartohet edhe metodologjia për Vlerësimin e Rrezikut të Pastrimit të Parave në Sektorin Bankar dhe produktet bankare si dhe është hartuar metodologjia e Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë për Vlerësimin e Rrezikut specifik për financim të terrorizmit përmes sektorit të OJQ-ve.

Sa i përket rritjes së veprimeve të koordinuara (kontroll/inspektim) të NJIF dhe organeve të zbatimit të ligjit në bizneset me rrezik të lartë (pjesë e listës së identifikuar nga NJIF), NJIF së bashku me BQK-në ka inspektuar një (1) Këmbimore dhe ka realizuar gjashtë (6) inspektime në institucionet financiare-këmbimore. Policia e Kosovës ka realizuar njëzet e gjashtë (26) Kontroll/Inspektime të koordinuara me NJIF-in dhe organe tjera të ligjit në biznese me rrezik të lartë. Po ashtu edhe Dogana e Kosovës në vazhdimësi ka raportuar në NJIF lidhur me deklaratimet dhe mos deklaratimet e mjeteve monetare në Pikë Kalimet Kufitare. Për më tepër, gjatë periudhës raportuese janë dërguar pesë (5) kërkesa lidhur me transaksione të dyshimta, ndërsa nga NJIF-K është pranuar një (1) kërkesë për të cilën është kthyer përgjigje.

Lidhur me rritjen e inspektimeve dhe aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në zyrat noteriale dhe agjencitë e paluajtshmërive, për të vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me Ligjin për PPP dhe FT, NJIF ka hartuar dhe miratuar Planin Vjetor të Mbikëqyrjes së Pajtueshmërisë për vitin 2022. Bazuar në analizën e rrezikut të pajtueshmërisë, inspektimet do të orientohen ndaj sektorit bankar-institucionet financiare dhe bizneseve dhe Profesioneve të Caktuara Jofinanciare (BPCJF) me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi. Është kontrolluar një (1) bankë dhe janë realizuar gjashtë (6) inspektime në institucionet financiare-këmbimore. NJIF-K ka lëshuar tridhjetë (30) Urdhëra për Monitorim dhe Ngrirje për subjektet raportuese (Bankat, Institucionet Financiare, Noterët, etj.), në të cilat kanë qenë të përfshirë apo përcaktuar rreth 1,746 persona dhe entitete. Këto Urdhëra të Monitorimit/Ngrirjes janë lëshuar me qëllim të zbatimit të Vendimeve të Qeverisë për vendosjen e sanksioneve financiare ndërkombëtare lidhur me ISIL (Da'esh) dhe Al Qaeda, Grupit Wanger, personave dhe entiteteve nga Federata Ruse dhe Bjellorusia lidhur me situatën në Ukrainë, si dhe OFAC listen.

Sa i përket bashkëpunimit funksional nga ATK dhe DK me Administratat e huaja tatimore dhe doganore përmas nënshkrimit të MM-ve, për forcimin e shëmbimeve ndërkombëtare të informacionit e veçanërisht lidhur me kompaninë amë apo ato të linjës, Dogana e Kosovës ka nënshkruar Protokollin për njohjen e plumbçeve mes Doganës së RKS dhe Doganës së Republikës së Shqipërisë. Po ashtu është nënshkruar Protokollin zbatues për funksionimin e profileve të riskut në zbatim të procedurave të transitit të mallrave përmes territorit të Republikës së Shqipërisë në territorin e Kosovës dhe anasjelltas.

Për tu rritur cilësia e monitorimit dhe procedurave penale të ndërtimeve për të zvogëluar ndërtimin e kundërligjshëm dhe ndërtimin e ndërtesave që nuk i përmbushin specifikacionet e kërkuara, Inspektorati i MMPHI-së, sektori i Ndërtimit dhe planifikimit, gjatë periudhës raportuese ka realizuar dyzet e tetë (48) inspektime ndaj subjekteve ekonomike, personave fizik si dhe ndaj inspektoratit komunal. Për shkeljet e konstatuara janë ngritur nëntë (9) kallëzime penale pranë prokurorive themelore si dhe inicime kundërvajtëse në gjykata. Për më tepër janë ngritur tri (3) kallëzime penale ndaj Komunave, bazuar në dyshimet e bazuara për shkeljet e konstatuara, ndërsa gjashtë (6) të tjera janë ngritur kundër personave fizik për tejkallimet e lejeve ndërtimore në ndërtimin e vikend-shtëpizave në Prevallë.

Në anën tjetër, Departamenti i Tatimit në Pronë në kuadër të MFPT-së, kryesisht për shkak të mungesës së stafit nuk ka filluar ende me ndonjë aktivitet konkret lidhur me rritjen e cilësisë së monitorimit dhe procedurave penale të ndërtimeve për të zvogëluar ndërtimin e kundërligjshëm dhe ndërtimin e ndërtesave që nuk i përmbushin specifikacionet e kërkuara.

Gjatë periudhës raportuese ASK ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të stafit në Divizionin e Ekonomisë joformale dhe llogarive qeveritare. Kurse, Trajnimi për “Forecast consolidation” i Divizionit të Politikave Fiskale për “Tax Expenditures and Impact Assessment” për shkaqe të pandemisë nuk është mbajtur.

**Në Objektivin specifik 1.4** është synuar zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë. Aktivitetet e parapara në kuadër të këtij objekti janë të natyrës vetëdijësuese për publikun dhe përmirësimit të kushteve të punës për organet zbatuese.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej njëmbëdhjetë (11) aktivitete, gjashtë (6) apo 55% prej të cilave janë zbatuar, tre (3) apo 27% janë në proces të zbatimit, ndërsa dy (2) apo 18% e tyre nuk janë zbatuar.

Lidhur me përgatitjen e udhëzuesit për metodologjinë e vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë së rasteve/prioritizimin dhe vendosjen e planit të inspektimit dhe trajnimit të stafit përkatës për përdorimin e metodologjisë, Inspektorati i Punës ka përgatitur listat kontrolluese dhe ka mbajtur trajnim për katër (4) punëtorë të Inspektoratit të Punës lidhur me vlerësimin e riskut, për mos zbatimin e dispozitave ligjore. Në kuadër të kësaj, janë realizuar vizitat në Shqipëri, Mal të Zi dhe Bosnje e Hercegovinë si dhe IP ka pasur në vizitë përfaqësuesit e Inspektoratit nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Gjatë periudhës janar-korrik 2022 janë kryer gjithsej 1,718 inspektime.

Sa i përket ndërtimit të një sistemi monitorues dhe sistemit për vlerësimin e performancës së punës së inspektorëve, Inspektorati i Punës ka filluar bashkëpunimin me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO) për konceptualizimin dhe zhvillimin e një platforme elektronike për inspektime, menaxhim të informatave dhe CRM (Customer Relation Management – Menaxhmenti i lidhjeve me konsumatorin).

Ndërsa lidhur me pajisjen e inspektorëve me mjete pune dhe vetura gjatë periudhës raportuese, aktiviteti nuk është zbatuar.


## Objektivi Strategjik II

Ky objektivi synon rritjen e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme. Rrjedhojë direkte e ekonomisë joformale është pakësimi i të hyrave nga tatimet në buxhetin e Kosovës dhe ekzistenca e pasurive të paligjshme private. Të dyja këto pasoja ndikojnë në sasinë e burimeve të përdorura për shërbimet publike dhe po ashtu rrisin shkallën e pabarazisë dhe të padrejtësive që kanë ndikim negativ për stabilitetin dhe harmoninë e brendshme të shoqërisë Kosovare.

Në kuadër të këtij objekti janë planifikuar gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktivitete, nga të cilat njëmbëdhjetë (11) apo 61% prej tyre janë zbatuar, dy (2) apo 11% janë në proces të zbatimit, kurse pesë (5) apo 28% prej tyre nuk janë zbatuar.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti janë të ndara në tre objektiva specifike.

**Grafiku 3:** Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik II



Burimi: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023

**Objektivi specifik 2.1** synon përmirësimin sasior të të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale. Ky objektivi specifik përmban gjithsej dy (2) aktivitete të cilat nuk janë zbatuar gjatë periudhës raportuese.

Për shkak të pandemisë por edhe mungesës së stafit e qarkullimit të madh të tij, MFPT nuk ka zbatuar aktivitetin lidhur me kryerjen e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektivi ekonominë joformale.

MFPT është ende në proces të kryerjes së studimeve apo vlerësimeve në fushën e ekonomisë joformale sipas standardeve ndërkombëtare lidhur me hendekun tatimor. Në bashkëpunim me Bankën Botërore, MFPT ka përgatitur vlerësimet preliminare të hendekut tatimor në Kosovë duke u bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjeve të ASK-së për periudhën 2015-2017 për vlerësimin e TVSH-së dhe TAP-it. Megjithatë rezultatet e vlerësimit nuk janë finalizuar ende.

Me **Objektivin specifik 2.2** është synuar rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit. Ky objektivi specifik përmban gjithsej dy (2) aktivitete të cilat gjatë periudhës raportuese nuk janë realizuar.

Sa i përket uljes së pragut lidhur me transaksionet në mes të bizneseve të cilat bëhen në kesh (aktualisht 500 EUR), MFPT është duke punuar në hartimin e Ligjit të ri për Administratën Tatimore dhe Procedurat andaj edhe aktiviteti ka pasur vonesa në zbatim.

Poashtu aktiviteti lidhur me dizajnimin e softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me numrin e kuponëve fiskal të lëshuar, kohën dhe artikujt në kohë reale (online) nuk është zbatuar.

**Objektivi specifik 2.3** ka për qëllim përmirësimin sasior të kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara. Ky objektivi specifik ka gjithsej katërbëdhjetë (14) aktivitete, nga të cilat njëmbëdhjetë (11) apo 79% janë zbatuar, dy (2) apo 14 % janë në proces të zbatimit, ndërsa një (1) apo 7% e tyre nuk është zbatuar.

Sa i përket rishikimit të formave standarde për shkëmbimin e të dhënave elektronike dhe në bartës fizik me qëllim shkurtimin e kohës së rrjedhës së informacionit në komunikimin ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, ATK ka negociuar njëzet (20) Marrëveshje Ndërkombëtare për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) konform legjisllacionit vendor dhe ndërkombëtar, ku tetëmbëdhjetë (18) prej tyre janë të zbatueshme. MFPT me Vendimin nr.72/2021, të datës 04.11.2021, ka caktuar ATK-në si autoritet kompetent për shkëmbimin e informacionit për marrëveshjet (METD) që janë në fuqi. Poashtu, ATK ka shkëmbyer tetë (8) shkresa dalëse dhe një (1) shkresë hyrëse për shkëmbim të informatave me shtetet me të cilat Kosova ka METD. Në janar të vitit 2022 kanë filluar të zbatohen dy (2) Marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) – me Holandën dhe Letoninë. Ndërsa, Dogana e Kosovës ka vijuar punën me zhvillimin e sistemeve elektronike për shkëmbim të informacionit me MINT-in. Inspektoratit të Tregut në kuadër të MINT i është dhënë qasje e drejtpërdrejtë në sistemin doganor Asycuda me qëllim të shenjëstrimit të dërgesave për kontrole të cilësisë. Gjithashtu është zhvilluar moduli për posta të shpejta, përmes të cilit iu mundësohet operatorëve që t'i deklarojnë mallrat para arritjes me qëllim të shkurtimit të kohës së zhdoganimit. Në anën tjetër, NJIF dhe Departamenti për Tatimin në Pronë në kuadër të MFPT-së gjatë periudhës raportuese diskutuan lidhur me modalitetet dhe vendosjen e bashkëpunimit, ku ndër të tjera, ranë dakord të lejojnë qasjen e drejtpërdrejtë të NJIF-K në bazën e të dhënave DPT. Gjatë periudhës raportuese janë shkëmbyer rreth 15,000 informacione në mënyrë elektronike.

Lidhur me aktivitetin e publikimit të Tabelës ofruese/përdoruese, ASK ka vazhduar me përpilimin e të dhënave për Tabelën ofruese/përdoruese, ku në kuadër të Projektit IPA2019 janë duke u përpiluar të dhënat për periudhën 2014-2016, ndërsa në kuadër të Projektit SIDA të dhënat për vitin 2019. Publikimi i të dhënave të Llogarive Kombëtare sipas tabelave ofruese-përdoruese (SUT) do të bëhet në TM4 2023.

Në anën tjetër, përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal nuk është zbatuar. Pengesa kryesore e këtij aktiviteti ishte situata me pandeminë e cila ndikoi edhe në këtë gjashtëmujor të periudhës raportuese. Po ashtu, Divizioni i Makroekonomisë i cili mirret me parashikime makroekonomike dhe fiskale, ka pasur qarkullim të madh të stafit gjatë vitit 2021.

NJIF ka planifikuar që të zbatojë në periudhën e dytë të vitit 2022 aktivitetin lidhur me zgjerimin e inspektimeve në sektorin e ndërtimitarisë dhe OJQ-ve lidhur me financimin e terrorizmit dhe pastrimin e parave, ku inspektimet tek subjektet e caktuara që paraqesin rrezik më të lartë të bazohen në inteligjencën financiare, tatimore dhe kriminale, me target kryesisht në sektorin e ndërtimitarisë.

Gjatë periudhës raportuese është funksionalizuar grupi i përbashkët DK-ATK për trajtimin e mallrave me rrezik të lartë të shmangies së taksave. Janë shkëmbyer të dhënat për subjektet e identifikuar

me risk mes dy institucioneve dhe janë marrë masa për verifikim dhe hetim të rasteve. Për më tepër gjatë kësaj periudhe, DK ka pranuar tridhjetë e tre (33) kërkesa për informacion nga ATK për të cilat janë dhënë përgjigje, si dhe ka dërguar shtatë (7) kërkesa për trajtim të rasteve të ndryshme që kanë të bëjnë me aktivitetin afarist të personave dhe kompanive të dyshimta për shmangie tatimore dhe janë zhvilluar katër (4) kontrole të përbashkëta.

Progres është arritur edhe në luftimin e kontrabandës së mallrave. Sipas Doganës së Kosovës, Njësitë Antikontrabandë kanë realizuar pesëdhjetë e një (51) plane operative të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in. Njësitë Antikontrabandë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në brendi të vendit, gjegjësisht në Zveçan kanë zbuluar laborator ilegal në sasi prej 10,000 bimëve narkotike me vlerë rreth 6 milion EUR, ndërsa vlera e laboratorit të sekuestruar vlerësohet të jetë rreth 1.5 milion EUR. Gjithashtu, gjatë kontrolleve doganore në ngarkesa të ndryshme me mallra, zyrtarët doganor në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në dy raste kanë zbuluar 83.6 kilogram heroinë si dhe 70 kilogram narkotik të llojit captagon, të cilat më pas i janë dorëzuar Policisë së Kosovës për hetime të mëtejme. Për më tepër, në sferën e bashkëpunimit ndërinstitucional Policia e Kosovës, Departamenti i Hetimeve në koordinim me Policinë Kufitare ka shkëmbyer 169 informata dhe ka realizuar tri (3) hetime të përbashkëta, pesë (5) operacione të përbashkëta dhe gjithsej ka realizuar tetë (8) takime operacionale të përbashkëta. Një ndër Operacionet e suksesshme të bashkëpunimit me Doganën e Kosovës në Piken Kufitare në Han të Elezit ka rezultuar me konfiskimin e rreth 83.5 kg substancë. Pastaj në vazhden e bashkëpunimit me ATK janë zhvilluar tri (3) takime me prokuroritë në Mitrovicë, Gjakovë dhe Prizren dhe tri (3) takime janë mbajtur me QPS-të. Ndërsa, Policia Kufitare e cila merret kryesisht me Kontrabandimin e mallrave ka prezantuar se ka iniciuar shtatëdhjetë e gjashtë (76) raste për veprën penale Kontrabandë me mallra, ka realizuar gjashtëmbëdhjetë (16) plane operative dhe ka organizuar shtatë (7) Operacione të përbashkëta me Institucionet tjera të MIK-ut (të përbashkëta me Agjencionet tjera).

Sa i përket aktiviteteve të ndërmarra për parandalimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, DK gjatë periudhës raportuese ka iniciuar 300 raste për verifikim të mallrave që dyshohen se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale apo 107% më shumë raste të iniciuara se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Janë ndaluar për verifikim 476,937 artikuj/mallra që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Poashtu janë konfiskuar mallra të falsifikuara në vlerë prej 2 milion EUR si dhe janë asgjësuar 83,042 artikuj në vlerë prej 1.3 milion EUR.

Për sa i përket rritjes së numrit të patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës, Njësitë Antikontrabandë të DK kanë realizuar 799 patrullime, 1,678 ndalesa rrugore, 3,632 kontrole në Pikë Kalimet Kufitare, tetëdhjetë e një (81) plane operacionale si dhe pesëdhjetë e një (51) plane operative të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in, me ç'rast kanë ngritur 140 kundërvajtje doganore për shmangie të detyrimeve doganore dhe kontrabandës me mallra në vlerë prej rreth 670 mijë EUR. DK në përgjithësi ka ngritur 848 kundërvajtje doganore për shmangie të detyrimeve doganore dhe kontrabandës me mallra, me vlerë të mallrave 2.7 milion EUR, që është një rritje në vlerë të mallrave prej 18% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si dhe ka shqiptuar gjoba në vlerë prej 509 mijë EUR.



Lidhur me aplikimin e kontrolleve pas importuese në bazë të menaxhimit të rrezikut dhe informacioneve tjera, gjatë periudhës raportuese DK ka zhvilluar gjashtëdhjetë e pesë (65) kontrolle pas importit të rregullt dhe pa paralajmërim. Janë lëshuar gjashtëdhjetë e pesë (65) aktvendime për inkasim të detyrimeve shtesë doganore në vlerë prej 3.08 milion EUR. Në fazën e inspektimit pas zhdoganimit janë inspektuar 17,397 deklarata doganore dhe janë rivlerësuar mallra në vlerë shtesë prej 282 mijë EUR. Poashtu është arritur të parandalohen mashtrimet në fushën e derivateve, gjegjësisht mashtrimet me lirimet nga taksat për derivate për qëllime të prodhimit si dhe mashtrimet me lirime në emër të përfaqësive diplomatike, ku efekti fiskal në parandalim vlerësohet të jetë mbi 4.5 milion EUR.

Sa i përket trajnimeve për ATK-në në fushën e menaxhimit të rrezikut, me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale dhe menaxhimit të rrezikut, ATK ka mbajtur gjithsej tri (3) trajnime brenda dhe jashtë vendit dhe në këto trajnime kanë marrë pjesë tetëdhjetë e dy (82) pjesëmarrës. Ndërsa lidhur me trajnimet e DK në fushën e zbatimit të ligjit janë mbajtur tridhjetë e një (31) trajnime të organizuara nga DK në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë si: EXBS (Export Control and Related Border Security Program), CEPOL (European Union Agency for Law Enforcement Training), WCO (World Customs Organization) dhe UNDP (United Nations Development Programme), ku janë trajnuar nëntëdhjetë e një (91) oficerë nga Drejtoria për Zbatim të Ligjit. Po ashtu janë mbajtur tri (3) trajnime lidhur me krimin ekonomik dhe korrupsionin, dy (2) të organizuara nga Bashkimi Evropian dhe një (1) nga Këshilli i Evropës - Projekti Kundër Krimit Ekonomik PECK III. Ndërsa lidhur me trajnime të dedikuara profesionalizmi të Prokurorëve për veprën penale të krimit ekonomik dhe pastrimit të parave, gjatë periudhës raportuese Prokuroria ka vazhduar me trajnimin e Prokurorëve në këtë fushë, ku janë trajnuar gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) prokurorë.

Ngjashëm, gjatë periudhës raportuese edhe NJIF ka realizuar trajnime për institucionet që monitorojnë aktivitetet në sektorin e ndërtimitarisë mbi PP/FT, lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet tjera financiare, posaçërisht në sektorin e ndërtimitarisë dhe patundshmërive (auditorë dhe inspektorë). Në mars të vitit 2022 NJIF përmes projektit të përbashkët BE/Këshilli i Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III) organizoi një trajnim dyditor për përfaqësuesit e OJF-ve të Kosovës mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT). NJIF me përkrahjen e Këshillit të Evropës organizoi dy sesione trajnime për identifikimin e pronarëve përfitues përfundimtarë me autoritetet e Kosovës. Janë zhvilluar aktivitete trajnuese për njëzet e nëntë (29) zyrtarë të “Pajtueshmërisë dhe Njihni Klientin Tuaj” që përfaqësojnë nëntë (9) banka në Kosovë si dhe për njëzet (20) zyrtarë të zbatimit të ligjit që përfaqësojnë PK, DK, ATK, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Prokurorinë. Me 21-22 prill të këtij viti është mbajtur trajnimi me temën “Transparenca e pronësisë përfituese si një mekanizëm efektiv për të luftuar keqpërdorimin e personave juridikë për qëllime të paligjshme” Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK III). Gjatë muajit qershor 2022 u mbajt trajnimi për bizneset dhe profesionet e përcaktuara jofinanciare (BPCJF) mbi kërkesat dhe detyrimet kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Në këtë aspekt, mbi shtatëdhjetë (70) avokatë, noterë, kontabilistë, auditorë dhe agjentë të makinave me qira morën pjesë në Trajnimin për Bizneset dhe Profesionet e Përcaktuara Jo-Financiare Kundër Pastrimit të Parave dhe Kundër financimit të Terrorizmit.

Poashtu, në kuadër të ngritjes së aftësive profesionale në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për Prokurorët, Gjyqtarët, Hetuesit dhe Inteligjencën Financiare, zyrtarët e NJIF gjatë periudhës raportuese kanë marrë pjesë në katërbëdhjetë (14) trajnime vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu, PK ka realizuar një mori trajnimesh, ku pjesëmarrës kanë qenë në shumë raste Prokurorë, Gjyqtarë dhe Hetues nga Inteligjenca Financiare. Në mesin e trajnimeve në nivel vendi janë realizuar gjashtëdhjetë e nëntë (69) trajnime ku pjesëmarrës kanë qenë 279 zyrtarë policor, poashtu në nivel vendi janë organizuar edhe tetëmbëdhjetë (18) punëtori, seminare dhe tryeza. Kurse, sa i përket trajnimeve në nivel ndërkombëtar janë realizuar nëntëmbëdhjetë (19) trajnime ku janë trajnuar gjithsej tridhjetë e gjashtë (36) zyrtarë policor dhe janë organizuar gjithsej tetë (8) punëtori me gjashtëmbëdhjetë (16) zyrtarë policor.

Përgatitja e Raportit gjashtëmujor janar-qershor 2022 i zbatimit të aktiviteteve të SLEJ 2019-2023 është rezultat i punës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, andaj i falënderojmë të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës për kontributin e tyre.

## Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues të Strategjisë Kombëtare

Strategjia Kombëtare identifikon institucionet e obliguara dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Mekanizmi për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku 4:** Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues të Strategjisë Kombëtare

